



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

KONTRATA

E përpiluar me datën **03.03.2020** ne Lipjan ndërmjet:

**Komunës së Lipjanit të cilën e përfaqëson Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan
z.Adem Duriqi në njërën anë (në tekstin e mëtejme) Autoriteti Kontraktues dhe**

Operatorit ekonomik "SIGNAL TECH SH.P.K.", Gjakovë, të cilën e përfaqëson, Egzon Tofaj,
Drejtor në vazhdim përdoret (shkurtesa) Kontraktuesi

Titulli i Kontratës: Furnizimi me mallra të cilat janë të nevojshme për mbjelljet pranverë vjeshtë
Nr. referues i kontratës **613 020 002 136**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është Furnizimi me mallra të cilat janë të nevojshme për mbjelljet pranverë vjeshtë.

Furnizimi do të bëhet në dy periudha, të gjithë artikujt të përshkruar në pjesën C do të furnizohen në pranverë, përveç artikujve me nr. rendor 2 të cilët do të furnizohen në vjeshtë, dhe nr. rendor 4 do të furnizohet një pjesë prej 1400kg në pranverë dhe pjesa tjetër prej 1600kg në vjeshtë respektivisht deri me datën 01.10.2020.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datë: 20.03.2020 dhe përfundon me datë: 01.10.2020, sipas paramasës dhe parallogarisë e cila është pjesë e kontratës dhe dosjes së kuotimit të çmimeve.

1.3 Afati kohor i kryerjes së furnizimeve fillon me datë: 20.03.2020 dhe përfundon 7 ditë pas fillimit për mbjelljet pranverore, ndërsa për mbjelljet vjeshtore afati i furnizimit fillon me 24.09.2020 dhe përfundon me datë: 01.10.2020.

1.4 Vendi i dërgimit për Furnizimi me mallra të cilat janë të nevojshme për mbjelljet pranverë vjeshtë është depoja e shkollës së mesme profesionale "Adem Gllavica" në Lipjan.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata Komunale Lipjan.

¹DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi përgjithshëm i kontratës për Furnizimi me mallra të cilat janë të nevojshme për mbjelljet pranverë vjeshtë shprehur në shifra është **3.555,55 €**; shprehur me fjalë tremijë e pesëqind e pesëdhjetë e pese /euro/ e pesëdhjetë e pese cent.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën e përgjithshme të pagesës pas kryerjes së të gjitha furnizimeve.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës nëse fatura e ka të bashkangjitur raportin e menaxherit të kontratës se shërbimet janë kryer me cilësi dhe në afat sipas planit dinamik të paraparë në kontratë. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garanton për cilësinë e farës, herbicideve dhe materialit tjetër për mbjellje pranverore dhe vjeshtore sipas specifikimit në dosjen e tenderit dhe nëse nuk i ka cilësitë e kërkuara ato do të kthehen dhe do të zëvendësohen me mallra tjera. *Dhe çdo mall që nuk e ka cilësinë e kërkuar do të kthehet kontraktuesit i cili është i obliguar që ta zëvendësoj me mall tjetër sipas paramasës.*

Neni 8

Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat]te kryej ndonjë ose të gjitha furnizimet* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *[furnizimeve]* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9

Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që të inspektojë dhe kontrollojë farërat dhe herbicidet, të cilat do të dorëzohen sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse këto produkte kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10

Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11

Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *resjudicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12

Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan në pajtim me ligjet e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] në 4 origjinale, 3 origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Adem Duriqi	Emri:	Egzon Tofaj
Pozita:	Drejtor i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

Seksioni II. FORMULARI I PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Specifikacioni i mbjelljeve: pranverore dhe vjeshtore 2020

Nr.	Pershkrimi i artikullit	Njesia matese	Sasia e kerkuar	Çmimi	Vlera
1	Pleh UREAper grur dhe miser ne siperfaqe 8/ha	Kilogram	2200	0.35	770
2	Farë gruri - varianteti pobeda	Kilogram	1600	0.35	560
3	Farë për misër sillazh NS 640	Thase	10	0.35	3.5
4	Pleh NPK 15:15:15 per grur ne siperfaqe 4/ha	Kilogram	3000	0.35	1050
5	Herbicid sekator për trajtimin e grurit (Boca 150 ml)	Cope	6	6	36
6	Herbicid furore super për trajtimin e grurit (1 Liter)	Cope	2	7	14
7	Herbicid master për trajtimin e misrit (1liter)	Cope	7	6	42
8	Insekticid mesurol (Boca 250 ml)	Cope	8	7	56
9	Pej per lidhje te bimeve furraxhere (balla)	Kilogram	40	0.35	14
10	Kryp I trash(per kafshe)	Kilogram	50	3	150
11	Herbicid total	Liter	20	4	80
12	Ushqim folijar	Liter	20	6	120
13	Insekticid movento 100 SC	Liter	1	7	7
16	Insekticid proteus 110 CD (shishe 500 ml)	Cope	1	7	7
17	Preparate për trajtim dimëror të mollave CRVENA ULJE	Liter	6	9	54
21	Domate - hibrid amate (qese prej 100 fara)	Cope	3	5	15
22	Domate - hibrid big be (qese prej 100 fara)	Cope	3	7	21
23	Specat - Hibrid Amand (sombork padjeges)	Gram	20	7	140
24	Specat - Hibrid Amand (sombork djeges)	Gram	20	6	120
25	Specat - Hibrid I Bardh I gjate pa djeges	Gram	20	6	120
26	Laken koke - hibrid melezk 4	Gram	5	10	50
27	Sallate gjethore - hibrid f1	Gram	30	2	60
28	Spinaq - hibrid f1 (qese pre 500 gr)	Cope	1	3	3
30	Qepujka	Kilogram	3	5	15
18	Fungicid per krom dhe hiri	Kilogram	6	6	36
14	Insekticid kunder morrit dhe pleshtave te mollave(shishe 500 ml)	Cope	2	6	12
Totali				3555.55	